

2019

GJYKATA E
APELIT
GOSTIVAR



RAPORTI VJETOR

Shkurt 2020

PËRMBAJTJA

I. TË DHËNA PËR PUNËN ME LËNDË	3
1) ADMINISTRIMI I GJYKATËS	4
2) KUALITETI I PUNËS NË NIVEL TË GJYKATËS	5
3) PUNA ME LËNDË NË NIVEL TË SEKTORËVE:	
A) SEKTORI PENAL.....	5
B) SEKTORI CIVIL.....	7
4) KUALITETI I LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORËVE:	
A) SEKTORI PENAL.....	8
B) SEKTORI CIVIL.....	9
5) GJENDJA ME LËNDËT E VJETRA.....	10
II. RAPORT PËR HAMRONIZIMIM E PRAKTIKËS GJYQËSORE.....	10
III. RAPORTI PËR VIZITAT E KRYERA TË GJYKATAVE NGA NIVELI ME I ULËT.....	11
IV. RAPORTI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	11
V. RAPORTI MBI TEKNOLOGJINË INFORMATIVE	11
VI. RAPORTI MBI KAPACITETET HAPSINORE DHE BURIMET NJERZORE:	
A)KAPACITETET HAPSINORE.....	13
B)BURIMET NJERZORE.....	13
VII. RAPORTI MBI PLANIFIKIMIN DHE KRYERJEN E PROKURIMEVE PUBLIKE	14

I.TË DHËNA PËR PUNË ME LËNDË

Gjykata e Apelit në Gostivar si organ i pavarur shtetëror gjykon mbi bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbi ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, me çka siguron aplikimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të nje riut.

Gjatë periudhës raportuese, gjykata me angazhimin maksimal profesional të të gjithë të punësuarve – gjykatësve, kuadrit profesional dhe personelit administrativ-teknik, mbetën të dedikuar në përpjekjet për kryerjen efikase dhe kualitative të detyrës gjyqësore, në korniza të kompetencave të saj me angazhimin maksimal dhe realizimin e programit për punë të vitit 2019.

Në këtë periudhë gjykata gjithsej lëndë në punë ka pasur 4.035, numër të cilin e përbëjnë 514 lëndë të përcjella si lëndë të pambaruara nga periudha raportuese e mëparshme dhe 3.521 lëndë të reja.

Domethënë, vëllimi i punës në krahasim me vitin e kaluar, kur numri i lëndëve shkoi deri në 4.442 u zvoglua për 921 lëndë që gjithsej janë 3.521.

Gjatë periudhës raportuese nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë, gjykata përfundoi 3.697 lëndë d.m.th 820 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar.

Në lidhje me lëndët e pambaruara në fund të vitit raportues kanë ngelur 338 lëndë.

Sipas të dhënave me statistikë numri i lëndëve në periudhën raportuese në krahasim me vitin e mëparshëm në **sektorin penal** është konstatuar rritje e numrit të përgjithshëm të lëndëve në regjistrin “KZH” dhe atë për 18 lëndë, regjistri “KSZH” rritje për 8 lëndë, në regjistrin “KZHM” rritje për 4 lëndë “KR” rritje për 18 lëndë, ndërsa në regjistrin “PRKZH” ka ulje të numrit të lëndëve për 373 lëndë në krahasim me vitin e kaluar. Në **sektorin civil** në periudhën raportuese ka ulje në të gjitha regjistrat dhe atë në regjistrin “GZH” për 46 lëndë, në regjistrin “ROZH” për 567 lëndë, ndërsa në regjistrin “TSZH” shënohet ulje prej 51 lëndëve dhe në regjistrin “R” për 7 lëndë më pak në raport me vitin e kaluar.

Regjistri	Lëndë të pambaruara në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
"KZH" lëndë penale të shkallës së dytë	38	410	448	392	56
"KZHM" lëndë penale të shkallës së dytë në procedure kundër të miturve	0	8	8	8	0
"KSZH" këshill penal i shkallës së dytë	2	176	178	173	5
"PRKZH" lëndë për kundërvajtje të shkallës	8	789	797	790	7

së dytë					
"KR" regjisti për lëndë të ndryshme penale	0	43	43	43	0
"GZH" lëndë civile të shkallës së dytë	331	1382	1713	1553	160
"ROZH" lëndë të shkallës së dytë konteste të marrdhënieve të punës	105	509	614	534	80
"TSZH" lëndë të shkallës së dytë në konteste të tregtisë	30	179	209	179	30
"R" regjisti për lëndë të ndryshme civile	0	25	25	25	0
GJITHSEJ	514	3521	4035	3697	338

1. ADMINISTRIMI I GJYKATËS

Në lidhje me administratën gjyqësore, vëllimi i lëndëve të reja në periudhën raportuese është 1.443 lëndë, që shënon rritje për 570 lëndë në krahasim me vitin e kaluar.

Nga ata 1.241 lëndë janë të regjistrimit "SU"-regjistrimi për administratën gjyqësore, 5 të "SU-DOV"-regjistrimi konfidencial i administratës gjyqësore, 56 "UPP"-regjistrimi për evidencë të parashtrësive dhe ankesave, 136 "IZZ"-regjistrimi për largimin e gjykatësve ose kryetarit dhe 5 "SPI"- regjistrimi për qasje të lirë deri te informatat.

Në periudhën raportuese të gjitha lëndët e administratës gjyqësore janë kryer.

Regjistrimi	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
SU-regjistrimi për administratën gjyqësore	0	1241	0	1241	1241	0
SU-DOV-regjistrimi konfidencial i administratës gjyqësore	0	5	0	5	5	0
SU-STR-DOV-regjistrimi konfidencial i rrjetit të administratës	0	0	0	0	0	0

gjqësore						
UPP-regjistri për evidencë të parashtrësive dhe ankesave	0	56	0	56	56	0
IZZ-regjistri për largimin e gjykatësve ose kryetarit	0	136	0	136	136	0
SPI- regjistri për qasje të lirë deri te informatat	0	5	0	5	5	0
GJITHSEJ	0	1443	0	1443	1443	0

2.Kualiteti i punës në nivel të gjykatës

Sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, gjykata ka mbajtur kualitetin e lartë të punës. Gjegjësisht nga 178 lëndë gjithsej të dërguara, të pranuar janë 163 lëndë nga të cilat 81 vendime janë të vërtetuara ose 49,70%, 5 vendime janë ndryshuar ose 3,06%, 21 vendime janë anuluar ose 12,88%, dhe 56 vendime janë hedhur poshtë ose 34,36%.

Lëndë të dërguara	Lëndë të pranuar	Të vërtetuara		Të prishura		Të ndryshuara		Të hedhura poshtë		Në mënyrë tjetër	
178	163	81	49,70%	21	12,88%	5	3,06%	56	34,36%	0	0,00%

3.Puna me lëndë në nivel të sektorëve

A) SEKTORI PENAL

Në sektorin penal në pajtim me orarin e punës së gjykatësve në Gjykatën e Apelit në Gostivar për vitin 2019, kanë vepruar pesë (5) këshilla penal nga të cilët dy këshilla veprojnë në zgjedhjen e lëndëve të regjistrin "KZH"- lëndë penale të shkallës së dytë dhe nga regjistri "PRKZH" - lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë ndërsa një këshill penal për zgjedhje të lëndëve nga regjistri "KZHM", në pajtim me Ligjin për të drejtat e të miturve dhe këshill i posaçëm i cili vepron vetëm me lëndët penale të regjistruara me regjistrin "KSZH" dhe "KR", një këshill penal me pesë (5) gjykatës për vepra penale me të cilat me ligj është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje deri më 15 vite ose me burg të përjetshëm.

Në sektorin penal në periudhën raportuese tërësisht në punë ka pasur 1.474 lëndë nga të cilat 48 lëndë janë përcjellur si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 1.426 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me

çka gjykata tërësisht ka zgjedhur 1.406 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 68 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithsej 1.799 lëndë, në periudhen raportuese fushëveprimi i punës u zvoglua për 325 lëndë, për shkak të fluksit të zvogluar që është për 292 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar.

Numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zvogluar për 345 lëndë në krahasim me vitin e kaluar. Ndërsa numri i lëndëve të pazgjedhura është 20 më i madh se vitin e kaluar dhe gjithsej janë 68.

Në periudhën raportuese në gjykatë në regjistrin “KZH” gjithsej ka pasur 448 lëndë, nga të cilat 38 lëndë janë transferuar si të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 410 lëndë të reja janë pranuar, me çka gjykata gjithsej ka zgjedhur 392 lëndë, ndërsa në fundin e vitit të pazgjedhura kanë ngelur 56 lëndë të cilat transferohen në vitin e ardhshëm.

Në regjistrin “KZHM” lëndë penale në procedurë kundër të miturve, të regjistruara janë 8 lëndë, të cilat janë zgjedhur gjatë periudhës raportuese.

Në regjistrin “KSZH” të regjistruara janë 178 lëndë, nga të cilat 176 janë lëndë të reja, ndërsa 2 lëndë janë transferuar në vitin e ardhshëm si të pazgjedhura. Nga këto janë zgjedhur 173, ndërsa 5 janë transferuar si të pazgjedhura prej vitit të kaluar.

Në regjistrin “PRKZH” lëndë për kundërvajtje janë regjistruar 789 lëndë, duke marrë parasysh edhe 8 lëndët nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 797 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 790 lëndë, ndërsa kanë ngelur të pazgjedhura 7 lëndë.

Në regjistrin “KP” gjithsej në punë ka pasur 43 lëndë të cilat në periudhën raportuese të gjitha janë zgjedhur.

Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- Deri një (1) muaj janë zgjedhur 990 lëndë,
- Prej një deri tre (1-3) muaj janë zgjedhur 287 lëndë,
- Nga tre deri gjashtë (3-6) muaj janë zgjedhur 107 lëndë,
- Mbi gjashtë (6) muaj janë zgjedhur 22 lëndë.

1. Puna e lëndëve në nivelin e sektorit penal

Regjistri	Lëndë të pambaruara në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që janë duke u punuar përsëri	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
KZH	38	410	0	0	448	392	56
KZHM	0	8	0	0	8	8	0
KSZH	2	176	0	0	178	173	5
PRKZH	8	789	0	0	797	790	0
KR	0	43	0	0	43	43	0
GJITHSEJ	48	1426	0	0	1474	1406	68

B)SEKTORI CIVIL

Në sektorin civil në pajtim me orarin e punës të gjykatësve dhe të punësuarve të tjerë për vitin 2019 kanë vepruar dy këshilla që veprojnë sipas lëndëve të regjistruara në regjistrin “GZH” - lëndë civile të shkallës së dytë dhe këshilli i tretë, i cili vepron sipas lëndëve të kontesteve tregtare dhe të marrëdhëniesve të punës në regjistrin “TSZH” lëndë të shkallës së dytë me konteste tregtare dhe regjistri “ROZH” lëndë nga konteste të marrëdhëniesve të punës. Në korniza të sektorit civil ekziston edhe këshill i veçantë që punon me lëndët P5 – vërtetim të përgjegjësive civile për fyerje dhe shpifje, dhe poashtu ekziston edhe këshill i veçantë që punon lëndët e lidhura me falimentim.

Në raport me vitin e kaluar në sektorin civil, kur Gjyqi në punë ka pasur gjithsej 2.561 lëndë nga të cilat 466 janë transferuar si të pazgjedhura prej vitit të kaluar dhe 2.095 janë pranuar të reja, me çka Gjykata ka zgjedhur gjithsej 2.291 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë ngelur të pazgjedhura 270 që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në lidhje me vitin e mëparshëm, kur gjykata në punë ka pasur 3.232 lëndë, fluksi i punës në periudhën raportuese është zvogluar për 671 lëndë dhe gjithsej janë 2.561, dhe kjo vjen si rezultat i zvoglimit të fluksit të lëndëve të reja, i cili është zvogluar për 629 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, gje gjësisht janë pranuar 2.095 lëndë.

Në regjistrin “GZH” lëndë civile, në punë ka pasur 1.713 lëndë, numër të cilin e kanë përbërë 331 lëndë të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 1.382 lëndë të reja të pranuar. Numri i lëndëve të zgjedhura janë 1.553, ndërsa të pazgjedhura kanë ngelur 160 lëndë.

Në regjistrin “TSZH” konteste tregtare, janë regjistruar 179 lëndë, dhe duke marrë parasysh dhe 30 lëndët e pazgjedhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 209 lëndë, nga të cilat janë zgjedhur 179 lëndë, ndërsa të pazgjedhura kanë ngelur edhe 30 lëndë.

Në regjistrin “ROZH” konteste të marrëdhënieve të punës janë regjistruar 509 lëndë, duke marrë parasysh edhe 105 lëndë të pazgjedhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 614 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 534 lëndë, ndërsa të pazgjedhura kanë mbetur 80 lëndë.

Në regjistrin “R” lëndë të ndryshme civile janë pranuar 25 lëndë dhe të njejtat janë zgjedhur, me çka nuk ka mbetje për vitin e ardhshëm.

Këshilli i cili punon në vërtetimin e përgjegjesisë civile për fyerje dhe shpifje në periudhën raportuese ka pasur 27 lëndë , nga të cilët 26 janë zgjedhur, ndërsa 1 lëndë është transferuar për vitin e ardhshëm. Ndërsa këshilli që punon lëndët e lidhura me falimentim gjithsej në vitin 2019 në punë ka pasur 3 lëndë nga të cilët të gjitha janë zgjedhur.

Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- Deri një (1) muaj janë zgjedhur 775 lëndë,
- Prej një deri tre (1-3) muaj janë zgjedhur 883 lëndë,
- Prej tre deri gjashtë (3-6) muaj janë zgjedhur 511 lëndë,
- Mbi gjashtë (6) muaj janë zgjedhur 122 lëndë.

1. Puna e lëndëve në nivelin e sektorit civil

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që punohen sërish	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
GZH	331	1382	0	0	1713	1553	160
ROZH	105	509	0	0	614	534	80
TSZH	30	179	0	0	209	179	30
R	0	25	0	0	25	25	0
GJITHSEJ	466	2095	0	0	2561	2291	270

4. Kualiteti i punës në Sektorin Penal

Sektori Penal në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyera nga Gjykata Supreme, ka mbajtur nivelin e lartë të punës.

Në periudhën raportuese gjithsej të dërguara janë 57 lëndë, ndërsa nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë kthyer 60 vendime, nga të cilat 30 vendime janë vërtetuar gjegjësisht 50% , 9 vendime janë anuluar gjegjësisht 15%, dhe 21 vendime janë hedhur poshtë gjegjësisht 35%.

■ Në regjistrin “KZH” janë pranuar 53 vendime, nga të cilët 24 janë vërtetuar (45,28% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 6,12% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 9 vendime janë anuluar (16,98% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 2,30% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), dhe 20 vendime janë hedhur poshtë (37,74% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 5,10% nga gjithsej lëndë të zgjedhura)

■ Në regjistrin “KSZH” janë pranuar 7 vendime, nga të cilat 6 janë vërtetuar (85,71% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 3,47% nga gjithsej lëndë të zgjedhura) dhe 1 vendim është hedhur poshtë (14,29% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,58% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

Regjistri	Lëndë të dërguara	Lëndë të pranuar	Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuara		Të hedhura poshtë	
			Numri	Porcentazhi	Numri	Porcentazhi	Numri	Porcentazhi	Numri	Porcentazhi
KZH	46	53	24	45,28%	9	16,98%	0	0	20	37,74%
KZHM	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KSZH	9	7	6	85,71%	0	0	0	0	1	14,29%
PRKZH	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	58	60	30	50%	9	15%	0	0	21	35%

Kualiteti i punës në Sektorin Civil

Sektorin Civil në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, ka mbajtur nivelin e lartë të punës.

Në periudhën raportuese gjithsej të dërguara janë 120 lëndë, ndërsa nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjithsej janë pranuar 103 vendime, nga të cilat 51 vendime janë vërtetuar gjegjësisht 49,52%, 5 vendime janë ndryshuar gjegjësisht 4,85%, 12 vendime janë anuluar gjegjësisht 11,65%, dhe 35 vendime janë hedhur poshtë gjegjësisht 33,98%.

■ Në regjistrin “GZH” janë dërguar 81 lëndë, nga të cilët janë pranuar 73 vendime dhe atë 41 të vërtetuara (56,17% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 2,64% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 2 vendime janë ndryshuar (2,73% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 0,13% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 8 vendime janë anuluar (10,96% nga numri i lëndëve sipas mjetit të

veçantë juridik, gjegjësisht 0,52% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), dhe 22 lëndë janë hedhur poshtë (30,14% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,42% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

■ Në regjistrin “TSZH” janë dërguar 17 lëndë, ndërsa janë pranuar 11 vendime, nga të cilët 3 vendime janë vërtetuar (27,27% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,68% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 3 vendime janë ndryshuar (27,27% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik gjegjësisht 1,68% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 3 vendime janë anuluar (27,27% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,68% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), dhe 2 vendime janë hedhur poshtë (18,19% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,12% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

Në regjistrin “ROZH” janë dërguar 22 lëndë, ndërsa janë pranuar 19 vendime, nga të cilët 7 vendime janë vërtetuar (36,85% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 1,31% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), 1 vendim është anuluar (5,26% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik gjegjësisht 0,19% nga gjithsej lëndë të zgjedhura), dhe 11 vendime janë hedhur poshtë (57,89% nga numri i lëndëve sipas mjetit të veçantë juridik, gjegjësisht 2,06% nga gjithsej lëndë të zgjedhura).

Regjistri	Lëndë të dërguara	Lëndë të pranuar	Të vërtetuara		Të ndryshuara		Të prishura		Të hedhura poshtë		Të zgjedhura në mënyrë tjetër	
GZH	81	73	41	56,17%	2	2,73%	8	10,96%	22	30,14%	0	0
TSZH	17	11	3	27,27%	3	27,27%	3	27,27%	2	18,19%	0	0
ROZH	22	19	7	36,85%	0	0	1	5,26%	11	57,89%	0	0
R	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	120	103	51	49,52%	5	4,85%	12	11,65%	35	33,98%	0	0

5) MBETJA E LËNDËVE DHE LËNDËT E VJETRA

Me angazhim maksimal të gjykatësve dhe të punësuarve në gjykatë, numri i lëndëve të vjetra prej viti në vit zvogëlohet. Pra, në këtë periudhë raportuese, si lëndë të vjetra në fund të vitit kanë ngelur 6 lëndë, nga të cilat 5 “GZH” dhe 1 “TSZH”.

II. RAPORT PËR HAMRONIZIMIM E PRAKTIKËS GJYQËSORE

Në pajtim me autorizimet e parapara me Rregulloren Gjyqësore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.66/2013) sektori për punë praktike, sjell plan vjetor për punë në sektorin e punës praktike në Gjykatën e Apelit në Gostivar për vitin 2019.

- Gjatë vitit 2019 janë kryer përgaditje për sjelljen e qëndrimeve ligjore për pyetjet kontestuese nga Sektori Penal dhe Civil, të cilat diskutohen në mbledhjet me tryeza të rrumbullakëta në nivel të katër (4) Gjykatave të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat tryeza të rrumbullakëta organizohen dy herë në vit.
- Janë mbajtur dy tryeza të rrumbullakta të të katër Gjykatave të Apelit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pyetje kontestuese juridike veçmas për sektorët penal dhe civil dhe janë marrë vendimet e mëposhtme me iniciativë të të katër Gjykatave të Apelit dhe atë:
 - Në sektorin Penal janë sjellë gjithsej 7 përfundime të cilat janë publikuar.
 - Në sektorin Civil janë sjellë 15 përfundime të cilat janë publikuar.
- Gjithashtu është kryer edhe përgaditja dhe selektimi i vendimeve të zgjedhura sipas sektorëve Penal dhe Civil për Buletin nr.3 për vitin 2019 i cili do të publikohet në fillim të vitit 2020.

III. RAPORT PËR VIZITAT E KRYERA NË GJYKATAT E NIVELIT MË TË ULËT

Bazuar në Metodologjinë për kryerjen e vizitave të punës në rajonin e Gjykatës së Apelit Gostivar dhe orarin e përcaktuar të vizitave të punës në gjykatat themelore nga ky rajon për vitin 2019, gjyqi në periudhën raportuese ka kryer dy vizita pune, njëra vizitë punë u organizua dhe u krye gjatë pjesës së parë të vitit 2019 në muajt Prill dhe Maj 2019 dhe vizita e dytë u organizua dhe u krye gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 në muajt Tetor dhe Nëntor 2019.

Për vizitat e kryera dhe marrja e masave gjatë vizitave, çdo gjykatës ka përgaditur raport në afat prej 8 ditësh nga vizita e kryer, i cili është dorëzuar deri te Gjykatat Themelore, Këshilli Gjyqësor, Gjyqi Suprem i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e drejtësisë.

IV. RAPORT PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Në pajtim me nenin 4 dhe nenin 12 të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.13/06, nr.86/08, nr.6/10, nr.42/14, nr.148/15, nr.55/16 dhe nr.64/18) personat juridik dhe fizik të vendit dhe të huaj kanë të drejtë për qasje të lirë deri te informatat e karakterit publik, që janë në lidhje me punën e kësaj gjykate. Në raportin e vitit 2019 në pajtim me ligjin e cituar më lartë, deri te kjo gjykatë janë dorëzuar gjithsej pesë (5) kërkesa të cilat kanë marrë përgjigje në afatin e caktuar me ligj. Kundër procesverbaleve të sjella deri te kjo gjykatë, të cilat kanë marrë përgjigje për informacionin e kërkuar të natyrës publike nuk është parashtruar asnjë ankesë deri te Komisioni për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë deri te informacionet e karakterit publik.

Asnjë ankesë nuk është dorëzuar në zyrën për marrëdhënie me publikun. Në lidhje me vendimet e publikuara në faqen e internetit për periudhën raportuese, janë publikuar gjithsej 3.572 vendime anonime.

V. RAPORTI PËR TEKNOLOGJINË INFORMATIVE

Funksionimi i gjyqit në periudhën raportuese në aspektin e teknologjisë informative u zhvillua pa pengesa, si dhe në pjesën e përdorimit të Sistemit informatik automatik për menaxhimin e lëndëve gjyqësore (AKMIS).

Sistemi AKMIS nga ana e të punësuarve përdoret plotësisht në të gjitha segmentet e punës. Çdo lëndë gjegjësisht çdo akt rregullisht regjistrohet në dosjet elektronike të lëndëve dhe përpunohen në përputhje me rrethanat. Të gjitha raportet e duhura mujore, tre mujore dhe vjetore përpunohen në mënyrë elektronike. Të njëjtat njëkohësisht dorëzohen deri te institucionet përkatëse dhe publikohen në web faqen tonë.

Në gjykatë ka një dhomë gjykimi ku është instaluar paisje për regjistrim të tonit të zërit gjatë seancave në pajtim me Ligjin për procedurë kontestimore. Kjo paisje rregullisht përdoret nga ana e gjykatësve nga sektori civil, tregtar dhe sektori për marrëdhëniet e punës duke ndjekur rregullat për regjistrim të tonit të zërit. Por, duke marrë parasysh domethënien e këtij sistemi dhe përdorimin e suksesshëm në të ardhmen duhet të sigurohet mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit për shkak të paisjeve tashmë të konsumuara.

Në lidhje me dërgesat elektronike, në këtë periudhë raportuese nuk janë paraqitur probleme dhe procedura e dërgesave elektronike po kryhet pa pengesa, vetëm drejt atyre avokatëve që janë regjistruar në portalin e dërgesave elektronike.

Në gjykatë rregullisht bëhet skenimi i të gjitha shtojcave në lidhje me lëndët gjyqësore që janë dorëzuar direkt në gjykatë. Në vitin 2019 janë skenuar gjithsej 202 shtojca, që janë dorëzuar në sektorin e duhur.

Anonimiteti i vendimeve të Gjykatës po kryhet pa pengesa dhe në periudhën raportuese janë publikuar gjithsej 3572 vendime anonime. Gjithashtu web portali i Gjykatës rregullisht përditësohet me raporte mujore, tre mujore dhe vjetore, si dhe me të gjitha informacionet e duhura për palët. Gjykata e Apelit në Gostivar gjithashtu ndjek punën e Gjykatave Themelore në rajonin që mbulon në lidhje me dërgesat elektronike, regjistrimin e tonit të zërit dhe procesin e anonimitetit dhe publikimit të vendimeve në baza javore.

Sa i përket harduerit të gjithë kompjuterat janë të mbrojtur nga një antivirus i licencuar. Përgjatë vitit 2019 është kryer prokurim i 6 kompjuterëve të ri me çka deri diku janë përmbushur kërkesat e Gjyqit, edhe pse 30% e të punësuarve punojnë me sistemin operativ Windows XP që nuk është i mbështetur nga Microsoft dhe kërkon zavendësim.

Nga formimi i gjykatës përdoret serveri i përhershëm, që mbulon punën e e çdo sistemi kompjuterik. Mbingarkesa dhe harxhimi i të njëjtit, ndjehet në punën e përditshme që sjell deri te ngadalsimi i punës. Në kuptim të kapacitetit të harduerit nuk i kënaq nevojat e gjykatës.

Nga fundi i vitit 2019 gjykata e rinovoi çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, me çka krijon, dokumenton, implementon dhe mirëmban sistemin me përmirësimin e tij të vazhdueshëm.

Puna me sistemin ABMS kryhet pa pengesa, përmirësohet në kohën e duhur dhe përgjatë periudhës raportuese nuk janë paraqitur probleme.

Rritja dhe modifikimi i teknologjisë informative kërkon që të gjithë të punësuarit të përmi rësohen dhe perfeksionohen vazhdimisht.

VI. RAPORT MBI KAPACITETIN HAPSINOR DHE BURIMET NJERZORE

A).KAPACITETET HAPSINORE

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit gjendet në Rr. “Zhivko Brajkovski” nr.1 në Gostivar. Hapsirat e punës janë të pajisura me mjetet elementare dhe inventar, ngrohja dhe ftohja e ndërtesës janë të siguruara me sistem qendror për ngrohje dhe ftohje, ndërsa lëndët janë të arhivuara në dollapë hekuri që janë të vendosur nëpër korridoret e gjykatës.

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit ka 27 hapsira pune, një sallë gjyqi, depo për inventar të vogël, depo për gjërat elementare dhe sallë serveri.

Gjendja e sigurisë së ndërtesës është e kënaqshme, ndërtesa e gjyqit gjendet në katin e tretë në objektin ku janë të vendosur dhe Prokuroria e Lartë Publike Gostivar, Prokuroria Themelore Publike Gostivar, Avokati i popullit si dhe Gjykata Themelore Gostivar, me çka ndërtesa është e siguruar nga ana e policëve gjyqësor të Gjykatës Themelore, që janë të angazhuar të kryejnë siguri të të gjithë ndërtesës dhe të objekteve të tjera 24 orë.

B) BURIMET NJERZORE

Në pajtim me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë Nr.07-1103/1 nga data 04.06.2012 në Gjykatën e Apelit në Gostivar numri i gjykatësve është vërtetuar në 16 gjyaktës duke përfshi edhe Kryetarin e Gjyqit.

Në pajtim me rregulloren e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën e Apelit në Gostivar SU.nr.0101-09/2019 nga data 11.01.2019 në këtë gjykatë numri i nëpunësve gjyqësorë dhe të punësuar sipas Ligjit për Marrëdhënie Pune është paraparë me 115 të punësuar dhe 8 policë gjyqësor.

Momentalisht funksionin e gjykatësve e kryejnë 13 gjykatës bashkë me kryetarin e gjyqit, ndërsa punët administrative i kryejnë 35 të punësuar nga të cilët 33 nëpunës gjyqësor dhe 2 të punësuar sipas Ligjit për Marrëdhënie pune.

Përbërja e gjyqit është si vijon:

Administratorë gjyqësor -1, inxhinjer i informatikës -1, bashkëpunëtor profesional – 7, bashkëpunëtorë i ri profesional – 9, bashkëpunëtor i ri/përkthyes – 2, referent i pavarur gjyqësor -1, bashkëpunëtor i ri – 1, referent i pavarur/kontabilist – 1, referent i lartë gjyqësor – 2, referent i lartë gjyqësor Arhiva e gjyqit – 1, referent gjyqësor/daktilograf – 5, referent i ri gjyqësor – 2, punëtor – 2 nga të cilët 1 shofer dhe 1 pastrues.

Gjykata e Apelit në Gostivar që të mund të angazhojë maksimalisht të gjithë të punësuarit, gjykatësit, kuadrin profesional dhe personelin administrativ teknik, që të kryejë punën efikase dhe kualitative në korniza të mundësive dhe kompetencave lind nevoja për punësim i numrit më të madh të kuadrin profesionaë dhe personelit administrativ teknik.

VII. RAPORT MBI PLANIFIKIMIN DHE PROKURIMET PUBLIKE TË KRYERA

Për funksionim normal të gjyqit, është sjellë edhe Plan Vjetor për prokurimet publike për vitin 2019. Në pajtim me Planin për vitin 2019 Kryetari u angazhua për zbatim të disa procedurave për prokurim publik të mallit, shërbimeve dhe punëve, sipas sistemit për prokurime publike dhe atë:

- prokurim i inventarit të vogël dhe mjeteve për mbajtje të higjienës,
- prokurim i materialeve për AOP tonerëve dhe pinterëve,
- grup i prokurimit publik për shërbime të internetit,
- prokurim për rikonstruimin e sistemit për ftohje dhe ngrohje të hapsirave të gjykatës
- prokurim i veturës,
- prokurim i paisjeve për monitorim me video,
- prokurim i kondicionerit për dhomën e serverit,
- prokurim i derës për detektim të metalit,
- prokurim i paisjeve informatike – kompjuterë për nevojat e gjykatës,
- prokurim grup i shërbimeve të Postës së Maqedonisë,
- prokurim grup i letrës për printim me gjykatat themelore nga rajoni i gjykatës së Apelit ne Gostivar,
- prokurim për mjete të zyrave – perde variolajt,
- prokurimi shërbimeve për linja fikse të telefonit,
- prokurim për mirëmbajtje të ndërtesës së gjyqit – punë për lysterje me ngjyrë të pjesës së brendshme të ndërtesës së gjyqit,
- prokurim dhe paisjen e Gjykatës së Apelit me çertifikatën për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015.

Gjithashtu në vitin 2019, u lidh marrëveshje për kryerje të shërbimeve të pranimit dhe dërgimit të letrave dhe shërbimeve të tjera postare dhe marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike dhe të internetit.

Gostivar, Shkurt viti 2020



